



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:084644  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05744047

**K.Dh.ShII.nr.342/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “AUTOSERVICEVALONI SH.P.K”, me NUI: 811473701, me seli në rr. “Sllatinë e Madhe” – Rruga e Pejës, në Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Fisnik Sogojeva, avokat në Prishtinë, kundër debitorit N.N.T “BAU - ING” – F.B.G. B.I., me NUI: 810603325, me seli në Lutogllavë, në Prizren, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Asman Hoxha, avokat në Prizren, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.1557/22 të datës 20.06.2023, me datë 24.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit N.N.T “BAU - ING, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1557/22 të datës 20.06.2023 **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1557/22 të datës 20.06.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit N.N.T “BAU - ING” me seli në Prizren ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 121/22, i lejuar me datë 05.04.2022,

nga Përmbauesi Privat Ilir Mullhaxha, dhe Urdhri Përmbauesor P.nr. 121/22, i lejuar me datë 05.04.2022, nga Përmbauesi Privat Ilir Mullhaxha, mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbauesore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës përmbauesore, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1557/22 të datës 20.06.2023 dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbauesore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “AUTOSERVICEVALONI SH.P.K” ka paraqitur propozim për përmbauesor P.nr. 121/22 të datës 05.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbauesimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 079/2021 të datës 21.10.2021, duke detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat e lartcekura t’i paguajë shumën e përgjithshme prej 380.01 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbauesore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar Urdhrin Përmbauesor P.nr.121/22 të datës 05.04.2022, duke theksuar se lejimi i urdhrin nga përmbauesi privat është në tërësi i pa bazuar dhe se nuk bazohet në prova materiale. Më tutje ka theksuar se dokumenti i paraqitur nuk i përmban tiparet e përmbaueshmërisë dhe se e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit. Në fund ka shtuar që debitori nuk është njoftuar asnjëherë për një faturë të tillë, andaj nisur nga ky fakt kreditori asnjëherë nuk ka kërkuar nga

debitori që të përmbush detyrimin. I ka propozuar gjykatës që urdhri përmbarimor i lartcekur të lihet në tërësi jashtë fuqie, si dhe të obligohet kreditori t'i paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore. Kreditori brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur përgjigje në prapësim duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se qëllimi i prapësimit nga ana e debitorit është vetëm shtyrja e përmbarimit. Lidhur me pretendimet e debitorit se fatura nuk përbën dokument të besueshëm një pretendim i tillë nuk qëndron, ngase në të është treguar kreditori dhe debitori, mjetet, lloji dhe objekti i përmbarimit si dhe afati i përmbushjes së detyrimit. Po ashtu ka theksuar se debitori ka pasur për detyre të kryej obligimet, vërtetohet edhe nga komunikimi përmes telefonit ku kreditori i ka kërkuar që të përmbush detyrimin dhe se debitori i ka premtuar se do ta përmbushë detyrimin, por që nuk e ka paguar. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar në tërësi prapësimi i debitorit, të lihet në fuqi urdhri përmbarimor, të urdhërohet debitori që në emër të garancionit për ankesë të paguaj shumën e borxhit të lartcekur, dhe të detyrohet debitori që të paguaj në tërësi shpenzimet e procedurës përmbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatit.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye: Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, "Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: "Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: "Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit".

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokument të besueshëm, përkatësisht Faturën Nr. 079/2021 të datës 21.10.2021, e cila i përmban

të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit dhe e njëjta është pranuar dhe nënshkruar nga debitori. Ka cek se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, dhe në rastin konkret gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore nga neni 71 i LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar ka konstatuar drejtë faktin se fatura nr. 079/2021 të datës 21.10.2021, në bazë të cilës organi përmbarues ka caktuar përmbarimin është dokument i besueshëm e kjo parashihet në nenin 29 paragrafi 1 të LPP-së, ku ceket se: përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është edhe fatura. Në rastin konkret fatura përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit konform nenit 21 si dhe nenit 29 paragrafi 3 i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*

*monetar*”, e që në rastin konkret fatura është e nënshkruar dhe e pranuar nga debitori dhe se e njëjta është në origjinal. Andaj edhe kjo gjykatë e pranon përfundimin juridik të gjykatës se shkallës së parë ngase aktvendimi i ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës ë Dytë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K. Dh.Sh.II.nr.342/24 me datë 24.05.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri